

BULETINI I IGJK Dhjetor 2003

Ky buletin është publikuar për informimin sa më të plotë të gjyqësive të Kosovës për aktivitetet e IGJK. Ky publikim është shpërndarë gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë. Buletini mujor i IGJK tani përmbanë artikuj nga stafi i IGJK në lidhje me qeshtjet me interes për gjyqtarët dhe prokurorët që punojnë në Kosovë.

HAPJA E LËNDËS PENALE /FILLIMI I PROCEDURËS PENALE/

Ndryshe nga të tjerat vende (P.sh. Gjermanisë) ku fillimi i procedurave penale për hetime paraprake, në veçanti konsiderohet të ketë zënë vend atëherë kur ndërmerren veprimet e para hetuese, ky fillim në Kosovë ka nevojë për një veprim më formal, roli i Prokurorit Publik (neni. 221. 1 CPC) është që të bëjë hapjen e hetimeve, dhe të mbledhë prova të vlefshme. Në kontrast me ish - Jugosllavinë ku Prokurori Publik e bën vetëm kërkesën, kurse gjyqtari hetues apo Gjykata marrin vendimin përfundimtar për fillimin e hetimeve paraprake, kurse tani Prokurori Publik është ai që e merr vendimin. Prokurori Publik lëshon vendimin për fillimin e procedurës penale dhe hetime paraprake, në veçanti kur ai/ajo posedon informata të vlefshme “dysime të arsyeshme që personi ka kryer vepra penale që është nën ndjekje penale ex officio” sipas (nenit. 220. 1 KPP). Prandaj, kjo informatë duhet të mjaftojë për dyshimet e arsyeshme jo vetëm për Shkeljen e mundshme por gjithashtu edhe për Shkelësin e mundshëm. Kështu që aktualisht, nuk lejohet që formalisht të kete hetime

paraprake kundër Shkelësit të panjohur të veprës penale edhe në qoftë se procedura të tilla egzistojnë atëherë, provat e mbledhura në këtë rast konsiderohen si të paligjshme. Në qoftë se prokurori në krye të rastit specifikon veprën penale dhe kryesin e saj, (atëherë pavarësisht se a kanë qenë të mjaftueshme apo jo informatat e dhëna) provat e mbledhura në këtë strukturë gjithmonë konsiderohen si të ligjshme. Kurse provat e mbledhura në hetimet paraprake duhet konsideruar si të paligjshme, vetëm në qoftë se shkojnë jashtë strukturës zyrtare. Për t’ju shmangur kësajë, Prokurori Publik duhet lëshuar vendimin shtesë për zgjerimin e procedurës në lidhje me Shkeljen e re të mundshme apo/ dhe Shkelësi i ri i veprës sipas (nenit.222 KPP).

Këtu mund të ekzistojnë dy lloje të burimeve të informatave për Prokurorin Publik, për japjen e ndihmës tij/saj sipas ligjit (i) raporti penal- vendor , apo (ii) raporti penal - ndërkombëtar – dhe kërkesat (drejtpërdrejt apo pas ekstradimit të refuzuar) nga një vendë tjetër për të filluar procedurat penale kundër banorit të Kosovës për veprën e



kryer në teritorin e saj apo kundër banorve të saj. Kështu që ndryshimet praktike në mes të dy llojeve të burimeve janë se ai paraprak zakonisht nuk është i nevojshëm, ndersa ky i mëvonshëm është i nevojshëm që Prokurori Publik për Shkeljen e mundshme të themelojë zbatimin shtesë të Kodit Penal në Kosovë. Kodi Penal ka mundësi të mos ketë gjeje zbatim në vepra penale në qoftë se Shkelësi i vepres jeton në Kosovë por nuk është banor i saj apo është bërë banor i saj në ndërkohë.

Shpesh herë burimet informative janë raportet penale të policisë për vepra penale dhe shpesh raportet e tilla (dhe raporte të tjera gjithashtu) nuk përmbajnë informata të cilat janë të mjaftueshme për të themeluar dyshimin e arsyeshëm se ekziston Shkelja dhe Shkelësi i mundshëm. Në raste të tilla sipas nenit. 209 (1) KPP në qoftë se “Prokurori Publik, nuk është në gjendje të kryej punën e mbledhjes së informatave të nevojshme atherë Prokurori duhet të kërkojë që policia gjyqësore t’i mbledhë këto informata”. idea për këtë është, në njërin anë që prokuroret dhe policia gjyqësore mos të mbingarkohen me materiale të parëndësishme të hetimeve zyrtare, por në anën tjetër, të mos kërkohet sqarim i plotë për raste të përmes veprave të verifikuara të cilat janë vetëm përsëritje të veprimeve hetuese më vonë. Kështu që është shumë e rëndësishme që të gjendet barazpesha e duhur.

Dhe gjithashtu duhet sqaruar që teksti ligjor i cituar në nenin.209 (1) KPP nuk pasqyron një terminologji të vërtetë për sqarimet e verifikimeve paraprake.

Zakonisht, roli i policisë gjyqësore në këto raste është rol ndihmës e as ai i policisë gjyqësore që i formon ato, (atëherë kur Prokurori Publik nuk mundet të kryej këtë punë vetëm). Ska dyshim që Prokurori Publik është figura kryesore në fazën e gjykimit paraprak, por kjo nuk do të thotë se ai/ajo duhet ta kryej pjesën më të madhe të punës. Në të kundrtën duke qenë figurë kryesore në këtë procedurë (si gjyqtar), Prokurori Publik duhet koncentruar vetëm në vlerësimin gjyqësor dhe t’i shmanget pjesës tjetër të punës me palë. Për këtë arsye Prokurori nuk është përgjegjës për mbledhjen shtesë të informatave nevojshme por është policia në përgjithësi. Prokurori Publik duhet të mbledh informata të tilla vetëm për raste të jashtëzakonshme (P.sh dëshmime të rrejshme), kur puna qartë nuk ka të bëjë me policinë. Përveç kësaj, sinjali i parë për vepër penale të kryer zakonisht nuk vjen nga policia gjyqësore por nga policia e zakonshme (nga policia në bashkësi, policia rrugore, etj.). Kështu që policia ndodhën në vendngjarjen e vepres kryer dhe me personat të cilet kanë parë apo ndëgjuar për këtë. Prandaj më së miri është që policia të mirret me mbledhjen e provave fillestare dhe shtesë në lidhje me shkeljen dhe shkelësit, në mes tjerash duke u përkujdesur për ruajtjen e gjurmëve, kështu që më vonë keto të mund të mbledhen dhe shërbejnë si prova. Përndryshe në qoftë se ai/ajo nuk është i përgaditur dhe inkurajuar në kryerjen e kësaj detyre atëherë në të kundërtën ai/ajo mënjanohet dhe dikush tjetër autorizohet të mbledhë informatat e nevojshme, (pamvarësisht nga ajo se a është Prokuror Publik apo polic



gjyqësor) kështu që pastaj informatat e marrura do të jenë me një sasi më të vogël dhe me kualitet më i ulët sa i përket mbështetjes në to. Sidoqoftë, gjithmonë është mirë që të shfrytëzohen dhe më pak të eliminohet policia të cilet kanë qenë të parët në përpjekje me Shkeljen dhe me Shkelësin e mundshëm. Në veçanti kur nevoiten informata shtesë, personi më adekuat për mbledhjen e tyre është polici/policja që merret me rastin. Polici gjyqësor i cili duhet bërë hetimet e mëtejshme gjithashtu mund të përfshihet nëse procedura penale është themeluar, por vetëm në fazën mëhershme (sipas praktikës së huaj pozitive) mënyra më e mirë për caktimin e tyre është tu ipet mendimi me shkresë qoftë për hapjen e rastit apo për të vepruar diçka tjetër. Përfundimi final nuk është të vazhdohet dispozita nga neni. 209 (1) CPC në pjesën e cila përcakton që së pari (i) informatat e nevojshme shtesë të mbledhen nga Prokurori Publik dhe (ii) në qoft se ai/ajo janë në gjendje ta kryejn punen vetëm, informatat duhet mbledhur nga policia gjyqësore. Pastaj, të dy rolet janë lloje të natyrës udhëzuese dhe mospajtimi me çdo njërin nga ata nuk mund të prodhojë ndonjë efekt negativ të procedurës, dhe nuk mund të kushtëzoj pavlefshmërinë apo mbledhjen e dëshmive.

Duhet pasur parasysh që sundimi i prokurorit publik të themeloj hetimet paraprake është gjithmonë veprim formal, që jo vetëm që është e nevojshme por është plotësisht e mjaftueshme për hapjen e rrugës për mbledhjen e çdo evidence valide, prandaj në përgjithësi janë të

rekomanduara proceduralisht, (për tu shmangur mbingarkimit gjyqësisë) por në tjetrën anë nuk është procedurë e detyrueshme që ky veprim i Prokurorit Publik të mbështetet nga informatat e mjaftueshme në lidhje me Shkelsin dhe Shkeljen e mundshëm. Në të kundërtën edhe pse këto informata nuk do të jenë të mjaftueshme për dyshim të arsyeshëm por vetëm por vetëm sa për identifikim të tyre, dhe vendimi i marrur duhet dorzuar dhe procedura për hetime paraprake duhet filluar. Kur ekziston mundësia gjatë një procedure të pazgjidhur masat e nevojshme duhet ndërmerrur urgjentisht: ose në teritorin e Kosovës (veprime të caktuara hetuese), ose kur rasti është jashtë vendit (të dërgohet një letërporosi apo të bëhet një kërkesë për kontroll ndërkombëtar dhe arrestim i përkohshëm i të pandehurit qëllimin për ekstradicim në të ardhmën). Për këtë arsye urgjenca e çështjes për raste të tilla gjithmonë duhet marrë në konsiderim me kujdesë pavarësisht nga ajo se informatat në lidhje me Shkelsin dhe Shkeljen e mundshme janë të mjaftueshme apo jo.

Në qoftë se Prokurori Publik i cili tashme posedon informatat e mjaftueshme në lidhje me atë se çfarë ka ndodhur ai vendosë se a të bëhet hapja zyrtarisht e rastit penal, ai/ajo duhet të konsideroj, së pari, se nëse vepra e kryer apo heqja, vërtet është veper penale e jo e llojit parëndesishëm në të cilin rast hetimet devijohen. Ndryshe nga vendet e Evropës Perendimore ku ky diversion i mundshëm është kryer jo nën parimet e rastit të volitshëm por ende nën parimet ligjore. Sipas nenit. 7 të këti



Kodi Penal në të cilin nuk parashihet si çështje mirësie (qëllim i mirë) por vetëm si çështje ligjore (detyrim) për lëshimin e rasteve të tilla.

Në të njejtën kohë duhet ta kemi parasysh edhe në Kosovë, hapja e këtyre rasteve në mënyrë zyrtare nuk është gjithmonë çështje e qeverisur vetëm nga parimet ligjore. Në këtë rast fleksibiliteti gjithmonë është i nevojshëm posaçërisht kur Shkelsi i mundshëm është banor i huaj në Kosovë. Në qoftë se Shkelja nga ai/ajo është e vogël dhe nuk ka palë të lënduar (p.sh. lidhur me dokumentin), pastaj nën teori të dëmit së shkallës ulët është e kshillueshme, por jo e detyriueshme për të nxjerrur Shkelsin e veprës jashtë Kosovës dhe dërguar një kërkesë në vendin të cilit ai/ajo vjenë që të fillohet një procedurë paraprake kundër tij/asaj. Vendim i till, i cili përjashtonë hapjen e rastit penal në mënyrë zyrtare, është plotësisht e drejtuar nga parimet e mundshme.

Në qoftë se aty nuk ekziston arsyeja për dërgim të lëndës jashtë vendit, Prokurori Publik e ka përcaktimin e mëtejshëm për të hetuar themelsinë e tij/saj, e cila përjashton fillimisht apo më vonë përgjegjësinë penale. Në qoftë se ai/ajo zbulonë dëshmi të tilla, është e jo arsyeshme të bëhet hapja e rastit. Kështu që konsiderim i veçantë duhet ti ipet imunitetit të mundshëm. Në qoftë se Shkelsi ka imunitet karakteri i tij duhet sqaruar. Nëse imuniteti i tij/saj është esencial, ai atëherë ai qendron nuk hjeket. Të gjithë antaret e Kuvendit janë imun nga procedurat penale në lidhje me fjalet e folura apo vepra të zbatuar në këtë pikpamje të kapacitetit tyre si antarë të kuvendit dhe asnjëherë nuk janë përgjegjës për vepra të tilla.

Për shkak të kësaj, hapja e rastit penal kundër atyre personave për çdo vepër në pyetje nuk janë të lejueshme. Por në qoftë se imuniteti i Shkelsit është vetëm procedural dhe mund të hjeket. (p.sh. të një agjenti diplomatik të huaj, shërbyes të UN-it nën urdhër të plotë të imunitetit procedural, dëshmitarët bashkëpunues, të ekstraduarit, dhe urdhërimin e pjesërishëm të imunitetit procedural) hapat e ndërmarrur në lidhje me këtë duhet marrur në konsideratë. Dhe në qoftë se ky imunitet është liruar me sukses, rasti penal duhet hapur.

Vendimi i Prokurorit Publik për hapjen e rastit duhet të ketë kërkesë zyrtare ta parashtrij në aktgjykimin e dytë sipas nenit. 221(1) KPP nën fjalën e dytë “ një kopje të vulosur me vendimin e hetimeve duhet dërguar pa vonesë tek gjyqëtari i gjykimit paraprak”. Me sa duket, kjo dispozitë, e regjenerimit mendimeve nga ligji i Ish-Jugosllavisë nuk është i qëndrueshëm me idenë në të cilën Prokurori Publik është dominus litis (zotërues) në fazën e gjykimit paraprak. Në çdo mënyrë kjo dispozitë është instruktive në tërësi. Nga një anë shkelja nuk duhet të trashëgojë pasoja negative në procedurë: kështu kur gjyqëtari i gjykimit paraprak ta pranojë dosjen e kompletuar nga hetimet e kryera deri më tani nuk mund të refuzoj vendimin mbi çështjen e asaj kompetence për të vetmen arsye që kopja e vendimit nga Prokurori Publik nuk i është dhënë ati/asaj në kohë të duhur. Kurse në tjetrën anë vonesa të tilla si mos plotësimi i dispozitave të diskutuara do të thotë se dosja e cila është pikë e akuzës në këtë fazë, është është nën zyrën e Prokurorisë e jo të Gjykatës.



Aktualisht, është më e rëndësishme nëse se i pandehuri nuk i takon nacionalitetit vendorë, kështu që Prokurori Publik ka për detyrë të kontrolloj se a ekzistonë ndonjë Konventë Konsulare në fuqi (që nga Ish-Jugosllavia e cila zbaton ligjin mbi mardhënie në mes të Kosovës dhe vendeve të huaja. Në qoftë se se kjo Konventë ekziston siguron obligimin që Konsulli të informohet për të pandehurin

në lidhje me hapjen e rastit penal. Në këtë pikpamje Prokurori Publik ka për obligim që pa ndonjë vonesë të ia dërgoj kopjen e vendimit dhe informatave të tij/saj me përmbajtjen e përfaqësimeve zyrtare nga vendi i të cilit i pandehuri vjen tek në Kosovë.

Dr. Anton Girginov, Trainues Gjyqësor
ne IGJK

Aktivitetet në dhjetor 2003.

- Trainimi mbi denimet dhe denimet alternative sipas dispozitave të Kodit të përkohëshëm penal të Kosovës
- Trainimi mbi Kodin e etikës dhe sjelljet profesionale të gjyqtarve dhe prokurorve
- Seminarii nga lëmia civile : qështjet pronësore
- Seminarii nga Kodi i Perkoheshem i Procedurës Penale të Kosovës

Trainimi mbi denimet dhe denimet alternative

2. dhjetor 2003.

Me datën 2. dhjetor 2003. IGJK planifikon trainimin mbi denimet dhe denimet alternative sipas dispozitave të Kodit të përkohëshëm penal të Kosovës i cili do të hyjë në fuqi me datën 6. prill 2004. Ky program do të adreson përmbajtjen e neneve 36. deri 41. të KPPK, si dhe punën dhe kompetencën e Shërbimit sprovues. Në agjendë gjindet edhe qasja praktike e denimeve alternative përmes prezentimeve dhe rasteve për studim. Gjyqtarët që punojnë në materjën penale dhe prokurorët publik janë të ftuar sepse kanë kompetenca të reja në përputhje me Kodin e ri.

Trainimi mbi Kodin e etikës dhe sjelljet profesionale

9. dhe 10. dhjetor 2003.

Ky do të jetë trainim dyditor i cili do të ipet së pari me 9. dhjetor dhe do të përsëritet me 10. dhjetor me grupin tjetër të pjesëmarrësve. Ky trainim është i katërti me radhë i cili ipet rregullisht. Qëllimi është që të trainohen të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët mbi Kodin e etikës dhe sjelljet profesionale, kompetencat dhe punën e Këshillit gjyqësor dhe prokurorial si dhe të Njësisë së inspektionit gjyqësor.



Seminari nga lëmia civile: qështjet pronësore

12. dhjetor 2003.

Për këtë seminar janë ftuar gjyqtarët që punojnë në lëminë civile. Temat do të përqëndrohen në kompetencat e gjykatave të rregullta dhe të Drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore dhe Komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore.

Seminari mbi Kodin e perkohëshem të procedurës penale

16. dhjetor 2003.

Ky seminar është i planifikuar për gjyqtarët që punojnë në lëndet penale dhe për prokurorët. Prezentimet do të jenë mi: gjyqtarin hetues dhe funksionin dhe kompetencat e tija, mardhënjet në mes të gjyqtarit hetues dhe prokurorit, rolin e prokurorit në procedurën e hetimeve, procedurën e marrjës në pyetje e të pandehurit, procesverbalin dhe vendimet e prokurorit gjatë hetuesisë. Ky seminar synonë në dhënjën e kuptimit më të kurtë dhe qasjen praktike të Kodit të perkohëshem të procedurës penale.

NGJARJET TJERA

Kalendari i trainimeve të IGJK për vitin 2004

IGJK ka përfunduar vizitat për konsultime me të gjitha gjykatat dhe prokuroritë në Kosovë dhe ka pranuar sugjerimet e tyre mbi temat nga lëmia penale dhe civile në të cilat ata dëshirojnë të pregaditen trainimet gjatë vitit të ardhshëm. Takimi i posaqëm me kontakt personat, përfaqësuesit të sekcioneve të OSBE dhe institucionet tjera ka mundësuar IGJK të marrë në konsideratë propozimet e tyre gjatë pregaditjes së programit vjetor për vitin 2004. Programi do të pregaditet para mbarimit të dhjetorit.

